



Shëno ID e Maturës

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

TESTIM PARAPRAK I MATURANTËVE

E premte, 11 maj 2018

Ora 11.00

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **21 pyetje**, 10 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 11 pyetje me zhvillim.

Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **1 orë**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21a	21b	21c	21d
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I***Projektet në shkollë****

Ka projekte shkollore si, të shkruarit apo përgatitja e fjalimeve, që i shtyjnë nxënësit të përfshihen individualisht dhe të japin më të mirën. Falë këtyre veprimtarive është e mundur të maten aftësitë e nxënësit, në lidhje me angazhimin e tij dhe mënyrën e të punuarit në projekt. Mirëpo, kjo nuk mund të thuhet edhe për projektet në grup, të cilat nisin në arsimin fillor dhe vazhdojnë në gjimnaz e universitet. Mësuesit pretendojnë se këto projekte do t'i përgatitin nxënësit për "botën e vërtetë", ngaqë i mësojnë të bashkëpunojnë me të tjerët. Por, ka shumë gjasa që ata i pëlqejnë, pasi është më pak e lodhshme të vlerësosh projektet në grup.

Për mendimin tim, janë disa arsye që i bëjnë projektet në grup, të jenë më pak përfituese për nxënësit.

Angazhimi i të gjithë pjesëtarëve të grupit është i rrallë. Më të shumtën e rasteve, një apo dy njerëz marrin përsipër tërë punën, kurse të tjerët ndihmojnë pak ose aspak. Disa nga pjesëtarët e kanë të qartë se dikush tjetër do të kujdeset që projekti të jetë gati në kohën e duhur. Tek e fundit, askush nuk dëshiron të ngelë apo jo? Për më tepër mësuesit, kur vlerësojnë, nuk bëjnë dallime midis anëtarëve. Nëse nxënësit guxojnë të thonë se të tjerët nuk kanë punuar në përgatitjen e projektit, ata trajtohen keq si nga nxënësit e tjerë, ashtu edhe nga mësuesit.

Pjesëtarët e grupit, shpesh, punojnë dhe mësojnë në mënyra të ndryshme, dhe kjo shkakton konflikte. Dikush dëshiron të punojë në mënyrë sistematike, një tjetër i shtyn gjërat për në momentin e fundit dhe nuk e përfundon punën deri një natë përpara dorëzimit të projektit. Në çdo grup ka njerëz të tillë. Pastaj, në çdo grup është dikush që vendos të udhëheqë. Unë, ashtu si dhe shumë të tjerë, kam qenë gjithmonë një "bletë punëtore", por pak e vlerësuar.

Projektet në grup kanë pasoja negative, edhe kur të gjithë pjesëtarët përfshihen dhe bëjnë punën që iu takon. Nxënësit kontribuojnë duke u bazuar në aftësitë që zotërojnë dhe nuk përfshihen në pjesët e tjera, me përjashtim të rasteve kur detyrat i cakton mësuesi. Ai që shkruan mirë, për shembull, merr përsipër të redaktojë dhe përpunojë materialin e shkruar, dikush që ka pasion informatikën merret me pjesën vizuale të projektit ose krijon një faqe interneti. Kjo siguron një notë të mirë, por nxënësit mësojnë shumë pak ose aspak gjëra të reja – ata thjesht bëjnë atë që dinë më mirë të bëjnë.

Për këto arsye, por edhe të tjera, mësuesit nuk duhet të caktojnë më projekte në grup. Nëse do të vazhdojnë ta bëjnë, nxënësit nuk do ta dinë me saktësi çfarë aftësish kanë dhe nuk do të jenë gati për botën e vërtetë.

**Kjo është një ese e shkruar nga një nxënës maturant në kuadër të një debati në lidhje me projektet individuale apo në grup që duhet të zhvillohen në shkollë.*

1. Ç'loj argumentesh mbizotërojnë në këtë tekst? 1 pikë
- A) Argumente logjike.
B) Argumente shkencore.
C) Argumente të autoriteteve të fushës përkatëse.
D) Argumente të mbështetura në të dhëna statistikore.
2. Cila nga fjalitë e mëposhtme shpreh më mirë **tezën** e kësaj pjese? 1 pikë
- A) Nxënësit duhet të jenë më të përgjegjshëm kur punojnë në grup.
B) Projektet në grup janë nxitëse kur të gjithë nxënësit ndihen të përfshirë.
C) Mësuesit nuk duhet t'i përfshijnë më nxënësit në projekte në grup.
D) Drejtuesit e shkollave duhet të jenë të kujdesshëm kur caktojnë llojet e projekteve.
3. Mbështetja e parë për argumentin e autorit vjen nga: 1 pikë
- A) kërkimet akademike.
B) gazeta të ndryshme.
C) të dhëna statistikore
D) vëzhgimet personale.
4. Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon më mirë qëndrimin e autorit në lidhje me anët negative të punës në grup? 1 pikë
- A) Për këto arsye, por edhe të tjera, mësuesit nuk duhet të caktojnë më projekte në grup.
B) Falë këtyre veprimtarive është e mundur të maten aftësitë e nxënësit, në lidhje me angazhimin e tij dhe mënyrën e të punuarit në projekt.
C) Nëse nxënësit guxojnë të thonë se të tjerët nuk kanë punuar në përgatitjen e projektit, ata trajtohen keq si nga nxënësit e tjerë, ashtu edhe nga mësuesit.
D) Ka projekte shkollore si, të shkruarit apo përgatitja e fjalimeve, që i shtyjnë nxënësit të përfshihen individualisht dhe të japin më të mirën.
5. Një pjesë e qëllimit të autorit është që ta bindë lexuesin.
Cila nga fjalitë e mëposhtme demonstroi pikërisht këtë qëllim? 1 pikë
- A) Më të shumtën e rasteve, një apo dy njerëz marrin përsipër tërë punën.
B) Për më tepër mësuesit, kur vlerësojnë, nuk bëjnë dallime midis anëtarëve.
C) Nxënësit kontribuojnë duke u bazuar në aftësitë që zotërojnë dhe nuk përfshihen në pjesët e tjera.
D) Unë, ashtu si dhe shumë të tjerë, kam qenë gjithmonë një "bletë punëtore", por pak e vlerësuar.
6. Argumenti i autorit mbështetet në konkluzionin se: 1 pikë
- A) puna në grup nuk nxit progresin e nxënësve.
B) nxënësit dëshirojnë të punojnë më shumë të pavarur.
C) kur punon vetëm, e kupton sa rëndësi ka puna në grup.
D) grupet japin informacionin më të dobishëm.

7. Identifikoni dy argumente në mbështetje të tezës.

2 pikë

8. Cila është kundërteza? Cilët janë mbrojtësit e saj? Zbuloni një argument në mbështetje të saj?

3 pikë

9. Në këtë pjesë ka disa momente kur autori përdor vetën e parë njëjës. Shpjegoni arsyen e secilit përdorim.

2 pikë

10. Cila është koha e foljes që mbizotëron në këtë pjesë? Shpjegoni një nga arsyet e këtij përdorimi.

2 pikë

11. Në ç'përfundim arrin autori në mbyllje të shkrimit? Çfarë ka të veçantë kjo mbyllje?

2 pikë

PJESA II

EPOSI I KRESHNIKËVE - “Martesa e Halilit” (fragment)

- N'vatër tande, Mujë, kemi qëllue,
 Mos na ki randë për një fjalë...
 Qysh Halilin s'e martove?
 Janë martue krejt mosha e tij...
 At'u dhimbën paret për me i dhanë?
 At'u dhimbën dasmat për me i ba?
 Tutna¹ djalin dikush po na e rre²
 Shpesh e shpesh po bie n'Kotorre t'Reja,
 Rob të gjallë djalin po e zanë;
 Le konakun, Mujë, po ta fikin,
 Ma zi fisin, Mujë, po na koritin...
 - Faqebardhë, more shokë, ju qofsha,
 Sa mirë hallin po ma ditki burra...
 Kujt po i dhimbsen dasmat për vlla t'vet?...
 Atëherë djali ka nisë me folë:
 - Kah kam vlla e kah kam motër,
 Vdeksha para n'u martofsha,
 Se gjithë gratë e krahinës ku janë...
 Bash si motra që po m'duken.
 Dheu m'ka mbulue e fat s'i qita vedit³
 Po s'e mora Tanushën e Krajlit
 E unë Tanushën vetë e kam pa:
 Gja ma t'mirë s'sheh njeriu nën këtë diell!
 Vetulla e saj e drejtë si fiskaja⁴
 Shtegu i ballit si shtegu i malit,
 Kur merr hana me prendue⁵
 Syni i saj si kokrra e qershisë,
 E ka qerpikun si krahu i dallëndyshes,
 Fytyra e saj si kuqet molla n'degë,
 Hunda e drejt-o si kalemi i Tushës⁶
 Goja e vogël si lulja që shpërthen,
 Dhambët e bardhë si gurëzit e lumit
 Fill mbas shiut, kur po i shndrit dielli,
 Qafa e saj si qafa e pëllumbit,
 Shtati i saj posi shtat çetine⁷
 Mishi i dorës pors i rremi⁸ i shemshirit⁹...

FJALOR

- | | |
|------------------------------------|--|
| 1. tutna - kemi frikë | 6. Tushës - argjendar i famshëm |
| 2. rre – gënjen | 7. çetine - pisha |
| 3. vedit - vetes | 8. rremi - dega |
| 4. fiskaja - thupër e hollë | 9. shemshiri – lloj druri |
| 5. prendue - perënduar | |

12. Shqetësimi kryesor në këtë fragment është:

1 pikë

- A) mosbindja e Halilit për të dëgjuar Mujin.
- B) shkelja e ligjeve të Malësisë nga Halili.
- C) pse Halili nuk po martohet ende.
- D) vështirësia për të gjetur një nuse të denjë.

13. Cili është reagimi i Mujit ndaj shqetësimin të kreshnikëve?

1 pikë

- A) Nervozohet nga ndërhyrja e tyre patak.
- B) Ndryshon temën e bisedës.
- C) Ndan me ta shqetësimin e vet.
- D) Mbetet pa fjalë dhe nuk di ç'të thotë.

14. Cili nga vargjet e mëposhtme është ndërtuar mbi figurën e hiperbolës?

1 pikë

- A) Fill mbas shiut, kur po i shndrit dielli,
- B) Gja ma t'mirë s'sheh njeriu nën këtë diell!
- C) Le konakun, Mujë, po ta fikin,
- D) Tutna djalin dikush po na e rre

15. Folja është përdorur në mënyrën dëshirore në vargun:

1 pikë

- A) - N'vatër tande, Mujë, kemi qëllue,
- B) Vdeksha para n'u martofsha,
- C) Bash si motra që po m'duken.
- D) Kujt po i dhimbsen dasmat për vlla t'vet?

16. Argumentoni përmes detajeve, të përdorura në vargjet ku përshkruhet portreti i Tanushës (*Vetulla e saj...*), se bukuria e saj është dhënë jo e ngrirë, por në lëvizje dhe tepër e gjallë.

3 pikë

17. Shpjegoni dallimin midis dy vargjeve të mëposhtme:

2 pikë

*Le konakun, Mujë, po ta fikin,
Ma zi fisin, Mujë, po na koritin...*

18. Ku është fokusuar më shumë rapsodi në përshkrimin e Tanushës? Pse?

2 pikë

19. Cili është qëllimi i rapsodit që mbledh aq shumë objekte dhe dukuri, nga më të bukurat e natyrës, për të bërë portretin e vajzës? Cila është figura e stilistikës e përdorur më shumë në këtë rast?

2 pikë

20. Gjuha e përdorur në Ciklin e Kreshnikëve ka forma gjuhësore të shqipes së vjetër. Gjeni në fragment një ndryshim fonetik dhe një leksikor.

2 pikë

Shqipja e vjetër

Shqipja e sotme

a. Fonetik

b. Leksikor

21. Ne e kuptojmë rëndësinë e kohës vetëm atëhere kur na ka mbetur shumë pak prej saj. A jeni dakord me këtë pohim? Pse? Argumentoni mendimin me shembuj nga përvoja juaj ose e njerëzve që njihni.

8 pikë

Shtjellimi i idesë (21a)	Organizimi dhe struktura (21b)	Stili dhe origjinaliteti (21c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (21d)	Totali
2	2	2	2	8